

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	DPA paraqiti një ekspozitë me dokumente mbi historikun e marrëdhënieve Shqipëri-Kinë.
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/dpa-paraqiti-nje-ekspozite-me-dokumente-mbi-historikun-e-marredhenieve-s-i588305
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 10:52:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 10:51:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	486265b571bf37962030217dc8b9921259a154e55636f636ff1387dd5047caaa
TEKSTI	d5444ad474a073780c99f5d07a2d6de0acf1a505d739a31cd4b904a59badea77
PAMJA	0d4f7b2dfd7bbbe79bad5a8f144a071f83c2d9edafc744e9ca68bb055b8df2ec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	35324c3fb88cd50ab743f4bd1abe5f902c5ee9dacb42b6d15270d37bdf53446a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/35324c3fb88cd50ab743f4bd1abe5f902c5ee9dacb42b6d15270d37bdf53446a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 
[Kontakt](#)

 English

ie [DPA paraqiti një ekspozitë me dokumente mbi historikun e marrëdhënieve Shqiperi-Kine. Netanyahu u bojkotua masivisht, zyrtari izraelit kontrolloi sallen dhe shenoi s](#)
fundit

DPA paraqiti një ekspozitë me dokumente mbi historikun e marrëdhënieve Shqipëri-Kinë.

 Tema

25 Shtator 2026, 12:51 Kulturë TEMA



Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave paraqiti një ekspozitë me dokumente origjinale mbi historikun e marrëdhënieve Shqipëri-Kinë.

Ekspozita solli për herë të parë, informacione lidhur me fillesat dhe ecurinë e qarqeve diplomatike, si edhe të marrëveshjeve ekonomike dhe kulturore mes dy vendeve.

Mes te pranishmeve ne ceremonine e inaugurimit te kesaj ekspozite ishin: zevendesarejtori i pergjithshem i DPA-se, Endrit Musaj, zevendesambasadori i Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Huang Xuehu, gazetari i filialit në shqip të “China Media Group”, Gëzim Podgorica, studiuesi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Gjon Boriçi, si edhe përfaqësuesit e Institutit “Konfuci”, Jin Qiao dhe Glendi Xhani.

“Dokumentet kanë një mënyrë të veçantë për të na afruar me historinë. Ato nuk na flasin vetëm me gjuhën e kujtimeve të vonshme, por me gjuhën e kohës kur janë krijuar. Në to gjenden, vendime, korrespondenca, takime, ide dhe marrëdhënie, që të marra së bashku na ndihmojnë të kuptojmë më mirë një periudhë të caktuar historike”, u shpreh Endrit Musaj.

Gëzim Podgorica vlerësoi përpjekjet e DPA-së për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe komunikimi me arkivën homologe të Kinës. “Mundësitë e komunikimit janë të gjera dhe sjellin një efekt pozitiv, sepse vendosin që trafiku i bashkëpunimit në urën tonë të miqësisë të rritet vazhdimisht. Nëse ne i nxisim dhe i gjejmë pikat e bashkëpunimit, jam i sigurt që puna dhe miqësia jonë do të rritet vazhdimisht”, tha Podgorica.

Mes dokumenteve origjinale që u paraqitën në këtë ekspozitë bënë pjesë procesverballi i vitit 1949 përmes të cilit pala kineze kërkonte vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, si edhe dokumenti lidhur me hapjen e ambasadës shqiptare në Kinë në vitin 1954.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Javës Kulturore Kineze dhe në vazhden e takimit të drejtorit të përgjithshëm të DPA-së, Auron Rrokaj me ambasadoren e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Pang Chunxue.

A.K./TemA

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"Diskriminon produksionet vendase"/ Shoqata e Kineastëve kundërshton projektligjin për kinematografinë

11:38 Kulturë

Rreth darvinizmit leksikor

10:34 Kulturë

Zbulimet e reja arkeologjike në Tepelenë, Rama: Po punohet për dokumentimin, pastrimin dhe konservimin e këtyre zbulimeve

09:42 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.